



# STATISTIKA EKONOMIKE PËR TURIZMIN

*Raportim*  
**6 MUJORI I PARË 2023**

# **PËRMBAJTJA**

## **HYRJE**

**1. TË ARDHURAT PËR PERIU DHËN JANAR – QERSHOR 2023**


**2. INVESTIMET E REJA NË FUSHËN E TURIZMIT**

**3. SHPENZIMET DITORE DHE NETËQËNDRIMET**

Industria e turizmit zë një vend të veçantë në ekonomi dhe është një burim i rëndësishëm për zhvillimin e vendit. Prodhimi i statistikave të harmonizuara me ofertën dhe kërkesën e turizmit, sot konsiderohet si vendimtar për t'u mundësuar vendimmarrësve të vlerësojnë dhe përmirësojnë këtë sektor të rëndësishëm ekonomik. Në këtë buletin statistikor po sjellim të dhëna ekonomike për disa zëra gjatë gjatëmujorit të parë të 2023, që tani janë mundësuar nga Banka e Shqipërisë. Ndërsa të dhënat për Strukturat Akomoduese janë mundësuar nga anketimet e bëra nga INSTAT.

### TE ARDHURAT DHE SHPENZIMET PËR PERIUDHËN JANAR – QERSHOR 2023


Bazuar në raportin e bilancit të pagesave të Bankës së Shqipërisë, të dhënat statistikore në udhëtim dhe turizëm gjatë 6-mujorit të parë 2023 (Janar–Qershor) tregojnë që ka rritje prej 39,5% krahasuar me viti 2022. Gjithashtu ky vit ka një rritje të konsiderueshme prej 84,8% krahasuar me vitin 2019. Të dhënat për gjashtëmujorin e parë në vitet e fundit janë si më poshtë:



**Grafik 1: Të ardhurat nga udhëtimet/turizmi të 6-mujorit të parë, për vitet 2019 – 2023.**  
(Burimi: Banka e Shqipërisë)

### SHPENZIMET PËR PERIUDHËN JANAR –QERSHOR 2023


Nga të dhënat e Bankës së Shqipërisë rezulton se shpenzimet e shqiptarëve jashtë vendit si për ata që lëvizin për arsye biznesi si ata për arsye personale për gjashtëmujorin e parë të vitit 2023 llogaritet të kenë shpenzuar 963.5 Mil Euro për zërin udhëtime/turizmi. Shpenzimet e shqiptarëve jashtë vendit për gjashtëmujorin e parë të vitit 2023 janë rritur në masën 21%. Më poshtë po japim një paraqitje grafike të shpenzimeve të shqiptarëve jashtë në vitet e fundit.



**Grafik 2: Shpenzimet e Shqiptareve per zërin udhëtimet/turizmi të 6-mujorit të parë, për vitet 2019 – 2023 (Burimi: Banka e Shqipërisë)**

### TË ARDHURAT NETO PË PERIUdhËN JANAR-QERSHOR 2023

Edhe të ardhurat neto nga udhëtim/turizmi në këtë 6-mujor të parë kanë shënuar rritje krahasuar me vitin paraardhës. Të ardhurat neto janë rritur 82 % krahasuar me vitin 2022. Rritja e të ardhurave neto është shumë herë më e madhe he krahasuar me vitin 2019. Më poshtë është grafiku me të dhënat për



**Grafik 2: Të ardhurat neto nga udhëtimet/turizmi të 6-mujorit të parë, për vitet 2019 – 2023 (Burimi: Banka e Shqipërisë)**

## INVESTIMET E REJA NË FUSHËN E TURIZMIT

Në vitet e fundit është rritur interesimi i biznesit për të operuar në fushën e turizmit. Interesant është fakti edhe pse sipërfaqja e ndërtimit është më e vogël se viti paraardhës vlera e investuar është 18 % më shumë, gjë që tregon rritjen e cilësisë të strukturave. Më poshtë gjendet tabela që tregon vlerat e krahasuar të gjashtëmujorit të parë në vitet e fundit:

Gjashtëmujori i I	2019	2021	2022	2023	Ndryshimi në % me 2022
<b>Numri i lejeve të ndërtimit për hotele e struktura të ngjashme</b>	39	11	31	35	12.9
<b>Vlera e përafërt e investuar (000 lekë)</b>	11,068,368	235,758	4,746,786	5,611,258	18.2
<b>Sipërfaqja e lejeve të ndërtimit miratuar (m2)</b>	310,962	5,964	127,816	61,914	-51,5

Tab 1: Burimi INSTAT

## SHPENZIMET DITORE DHE NETËQËNDRIMET

Një faktor i rëndësishëm në llogaritjen e të ardhurave që sjell turizmi në vend është dhe llogaritja e netëqëndrimeve për vizitorët e huaj, që shpenzojnë 1 natë e më shumë në Shqipëri, si dhe shpenzimet mesatare ditore që të huajtë (jo rezidentë) shpenzojnë në Shqipëri.

Përsa i përket **shpenzimeve mesatare ditore** për 6 mujorin e parë të 2023 **për shtetasit e huaj jorezidentë** që vizitojnë Shqipërinë **për qëllime biznesi**, mesatarja ditore e harxhimit është 121,5 Euro, që llogaritet 20 euro më shumë krahasuar me të njëjtën kategori të një viti më parë. Ndërsa shtetasit e huaj që kanë qëndruar në Shqipëri **për arsye personale** kanë harxhuar një mesatare ditore prej 68 euro në ditë. Rritja është 3 Euro në ditë më shumë se mesatarja ditore e shpenzuar për arsye personale, në të njëjtën periudhë të vitit paraardhës.

Përsa i përket **kohëqëndrimit mesatar për jorezidentët**, shifrat tregojnë se vizitorët e huaj që vijnë për qëllime personale gjatë periudhës gjashtëmujore të 2023 kanë një mesatare prej 5.5 netëqëndrimi. Ndërsa jorezidentët që kanë deklaruar si qëllim të vizitës së tyre në Shqipëri, arsye biznesi kanë pasur një mesatare prej 4,5 netë. Netëqëndrimet për arsye personale janë të njëjta me vitin paraardhës kurse netëqëndrimet për arsye biznesi janë ulur me një 0.5 netë krahasuar me mesataren e netëqëndrimeve të të njëjtës periudhë të një viti më parë.